

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: LUBRIFIKANT

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

24951100-6

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 3 327 379,40(tre milion e treqind e njëzetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë presje dyzet lekë).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Nw zbatim tw nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshitetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik te ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjithë adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. (Nëse katalogu/ broshura/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontrakto..

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”/ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon mundësinë e verifikimit të certifikatave pranë DPA në Ministrinë e Financave.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori Ekonomik duhet të provojë gjithashtu se ka importuar drejtpërdrejt nga prodhuesi mallra të së njëjtës natyrë gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit nga data e publikimit të procedurës.

Si provë do të paraqitet kopje e dokumentacionit të zhdoganimit (deklaratë doganore), ku të rezultojë qartë prodhuesi/furnitori dhe lidhja direkte me të.

Mosparaqitja e dokumentacionit të mësipërm përbën shkak për skualifikim.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesa që operatori ekonomik të provojë se ka importuar drejtpërdrejt nga prodhuesi mallra të së njëjtës natyre gjatë 6 muajve të fundit, përmes paraqitjes së dokumentacionit të zhdoganimit (deklaratë doganore), synon të verifikojë përvojën reale të operatorit në furnizimin me produkte të kësaj kategorie dhe ekzistencën e marrëdhënieve të drejtpërdrejta tregtare me prodhuesin ose furnitorin zyrtar.

Kjo kërkesë shërben gjithashtu për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitet real furnizimi dhe akses në zinxhirin e furnizimit, ka eksperiencë konkrete në importimin dhe menaxhimin e këtyre produkteve, siguron produkte me origjinë të qartë dhe të verifikueshme, redukton rrezikun e furnizimit me produkte jo origjinale ose jashtë standardeve të kërkuara.

Në këtë mënyrë, vendosja e këtij kriteri konsiderohet e arsyeshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi synon të garantojë që furnizimi do të realizohet nga operatorë ekonomikë që kanë kapacitetin teknik dhe tregtar për të siguruar produkte cilësore dhe të certifikuar.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit:

- **Kodi VIII.1.A**
- Kategoria: Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri
- Nënkatëgoria: Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse
- Emërtimi i veprimtarisë: Tregtimi me shumicë i vajrave lubrifikantë – Kategoria IV/A

Licenca duhet të jetë në fuqi në momentin e dorëzimit të ofertës, në emër të operatorit ekonomik ofertues dhe e shoqëruar me kopje të NUIS/NIPT-it.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë që operatori ekonomik të jetë i pajisur me Licencë të vlefshme me Kodin VIII.1.A, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është vendosur me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe sigurisë së ushtrimit të aktivitetit që lidhet me tregtimin e produkteve hidrokarbure.

Kjo licencë i përket kategorisë së veprimtarive që lidhen me prodhimin, depozitimin, transportin, përdorimin dhe tregtimin e produkteve të rrezikshme, konkretisht tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, përfshirë edhe vajrat lubrifikante dhe lëndët djegëse.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi objekti i procedurës lidhet me furnizimin ose përdorimin e produkteve që bëjnë pjesë në kategorinë e hidrokarbureve dhe produkteve të ngjashme, të cilat konsiderohen produkte me potencial rrezikshmërie dhe kërkojnë që operatorët ekonomikë të jenë të autorizuar dhe të kontrolluar nga institucionet përgjegjëse të shtetit.

Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të sigurojë që operatorët pjesëmarrës në procedure të ushtrojnë ligjërisht aktivitetin ekonomik përkatës, të jenë të pajisur me kapacitetet teknike dhe infrastrukturore të nevojshme për tregtimin dhe menaxhimin e këtyre produkteve, të respektojnë kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë në trajtimin e produkteve të rrezikshme.

Për këtë arsye, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë licencë të vlefshme me Kodin VIII.1.A në momentin e dorëzimit të ofertës të shoqëruar me NIPT/NUIS, konsiderohet një kriter proporcional dhe i nevojshëm për realizimin e kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit:**

- **Kodi III.2.B**
- **Kategoria:** Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
- **Nënkategoria:** Veprimtari të tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
- **Emërtimi i veprimtarisë:** Grumbullim, transportim dhe ruajtje e vajrave lubrifikante

Licenca duhet të jetë në fuqi në momentin e dorëzimit të ofertës dhe e lëshuar në emër të operatorit ekonomik ofertues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë që operatori ekonomik të jetë i pajisur me Licencë të vlefshme me Kodin III.2.B, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin profesional për të kryer veprimtari që lidhen me grumbullimin, transportimin dhe ruajtjen e vajrave lubrifikante.

Vajrat lubrifikante dhe nënproduktet e tyre, veçanërisht kur përdoren ose trajtohen pas përdorimit, konsiderohen substanca që mund të kenë ndikim në mjedis, ndaj trajtimi i tyre kërkon respektimin e standardeve dhe rregullave të posaçme mjedisore.

Për këtë arsye, licenca III.2.B, e cila lidhet me shërbimet profesionale dhe veprimtaritë që ndikojnë në mjedis, është e nevojshme për të siguruar që operatori ekonomik disponon autorizimin për menaxhimin e këtyre produkteve, respekton kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, ka kapacitetin teknik dhe profesional për trajtimin, transportin dhe ruajtjen e vajrave lubrifikante.

Vendosja e këtij kriteri synon të garantojë që proceset e lidhura me menaxhimin e vajrave lubrifikante të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, duke minimizuar çdo rrezik të mundshëm për ndotje.

Në këtë kuadër, kërkesa për paraqitjen e licencës së vlefshme me Kodin III.2.B në momentin e dorëzimit të ofertës, është një kriter i arsyeshëm dhe proporcional për realizimin e sigurt dhe në përputhje me ligjin të kontratës objekt prokurimi.

2.3.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e mëposhtem:

- **VAJ MOTORR SAE 10W40**
- **VAJ MOTORRI SAE 15W40**
- **VAJ MOTORRI SAE 20W50**
- **VAJ MOTORRI SAE 5W40**
- **VAJ MOTORRI SAE 30**
- **VAJ MOTOTRRI SAE 5W30**
- **VAJ KAMBIO 80W90**
- **SAE 10 W**

Ky kriter I shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që ato duhet të kenë.

Mostrat do të dorëzohen pranë AK në ditën dhe orën e parashikuar për hapjen e ofertave.

Shënim: Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara përbën kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, tënenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullavete Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor për cakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike për artikujt e kërkuar nga autoriteti kontraktor:

Specifikimi i Materialeve:

SAE Grade: 10W-40

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	12.50 – 16.30
Viskoziteti në -25°C (cP)	ASTM D5293	< 7000
HTHS në 150°C	ASTM D5481	> 3.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	150
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	205
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-42
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 1.0
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 12.0

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API CK-4
- ACEA E4, E7, E8, E11
- Volvo VDS-4
- MTU Oil Category 2.1 / 3.1
- DTFR 15C100 (MB 228.31)
- DTFR 15C110 (MB 228.51)
- DTFR 15C120 (MB 228.52)
- MAN M3275 / 3277 / 3575 / 3677 / 3477
- Mack EO-O Premium Plus
- DDC PGOS 93K218
- Cummins CES 20081
- Caterpillar ECF-3
- RVI RLD-2 / RLD-3
- JASO DH-2
- Deutz DQC IV-10LA
- Iveco 18-1804 NG2 / 18-1809 NG2

SAE Grade: 15W-40

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	12.50 – 16.30
Viskoziteti në -20°C (cP)	ASTM D5293	< 7000
HTHS në 150°C	ASTM D5481	> 3.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	150
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	205
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-38
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 2.0

Parametri	Metoda	Vlera
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 9.9

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API CI-4 / SN
- ACEA A3/B4, E7
- MAN M3275
- IVECO PEGASO
- DAF XF
- RENAULT RLD-2
- MB 229.1
- DTFR 15B110 (MB 228.3)
- SCANIA LDF
- VOLVO VDS-3
- DEUTZ DQC III-10

SAE Grade: 20W-50

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	16.3 – 21.9
Viskoziteti në -15°C (cP)	ASTM D5293	< 9500
HTHS në 150°C	ASTM D5481	> 3.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	150
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	218
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-34
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 2.0
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 9.0

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API CI-4 / SN
- ACEA A3/B4, E7
- MAN M3275
- IVECO PEGASO
- DAF XF
- Renault RLD-2
- MB 229.1 / 228.3
- Scania LDF
- Volvo VDS-3
- Deutz DQC III-10

Tipi: Vaj Hidraulik HLP 68

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- DIN 51524 Part 2 HLP
- ISO 6743-4 HM / ISO 11158 HM
- AFNOR NF-E 48-603 HM
- Parker Denison HF-0, HF-1, HF-2
- Eaton Brochure 03-401-2012
- Fives Cincinnati P-68 (32), P-70 (46), P-69 (68)
- Bosch Rexroth 90220 (46)
- Engel (46)

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE (ISO 68)

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	8.6
Viskoziteti në 40°C (cSt)	ASTM D445	68
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	97
Dendësia në 15°C (g/cm ³)	ASTM D4052	0.882
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	246
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-24
FZG, Damage Stage	DIN 51354	11
4-Ball Wear, scar diameter (mm)	ASTM D4172	0.45
Rezistenca ndaj oksidimit (mg KOH/g)	ASTM D943	< 2
Demulsifikimi (54°C)	ASTM D1401	< 30 min
Korrozioni në bakër (3h / 100°C)	ASTM D130	1b

SAE Grade: 5W-40

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- ACEA A3/B4
- API SN / CF
- GM-LL B-025
- MB 229.5
- VW 502.00 / 505.00

- BMW LL-01
- Renault RN 0700 / 0710
- Fiat 9.55535-M2
- PSA B712296
- Porsche A40

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	12.50 – 16.30
Viskoziteti në -30°C (cP)	ASTM D5293	< 6600
HTHS në 150°C	ASTM D5481	> 3.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	160
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	227
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-39
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 1.6
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 10.0

SAE Grade: 30

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API CF / SF
- Allison C3
- CAT TO-2
- MAN 270
- MB 228.0
- MTU Type I

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	9.3 – 12.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	110
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	220
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-30
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 2.0
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 6.0

SAE Grade: 5W-30

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- ACEA C3
 - API SN / CF
 - VW 504.00 / 507.00
 - BMW Longlife-04
 - Porsche C30
 - MB 229.52
-

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	9.3 – 12.5
Viskoziteti MRV në -30°C (cP)	ASTM D5293	< 6600
HTHS në 150°C	ASTM D5481	> 3.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	155
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	220
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-42
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 0.8
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 6.0

Produkt: Vaj Transformatori

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskozitet kinematik në 40°C (cSt)	ISO 3104	Maks. 12.0
Viskozitet kinematik në -30°C (cSt)	ISO 3104	Maks. 1800
Pika e rrjedhjes (°C)	ISO 3016	Maks. -40
Përmbajtja e ujit (mg/kg)	IEC 60814	Maks. 30
Tensioni i shpërthimit (para trajtimit), kV	IEC 60156	Min. 30
Tensioni i shpërthimit (pas trajtimit), kV	IEC 60296	Min. 30
Dendësia në 20°C (kg/dm³)	ISO 12185	Maks. 0.895

Parametri	Metoda	Vlera
DDF në 90°C	IEC 60247 Maks. 0.005	
Pamja	IEC 60296 E pastër, pa sediment	
TAN (mg KOH/g)	IEC 62021 Maks. 0.01	
Tensioni ndërfaqësor (mN/m)	EN 14210 Min. 43	
Përmbajtja totale e squfurit (%)	ISO 14596 Maks. 0.05	

PËRBËRJA & PASTËRTIA

Parametri	Metoda	Vlera
Squfur korroziv	DIN 51353	Jo korroziv
Squfur potencialisht korroziv	IEC 62535	Jo korroziv
Squfur korroziv	ASTM D1275 B	Jo korroziv
DBDS (mg/kg)	IEC 62697-1	Nuk u zbulua
Antioksidant (% peshë)	IEC 60666	0.08 – 0.4
Përmbajtje metali	IEC 60666	Nuk u zbulua
2-Furfural & komponime të ngjashme	IEC 61198	< 0.05
Përmbajtje aromatike (%)	IEC 60590	5
Stabilitet oksidimi (120°C / 500h) – TAN —		Maks. 0.3
Stabilitet oksidimi – Sludge (%)	IEC 61125 C	Maks. 0.05
Stabilitet oksidimi – DDF (90°C)	—	Maks. 0.05
Pika e ndezjes (°C)	ISO 2719	Min. 135
PCA (% peshë)	IP 346	Maks. 3
PCB	IEC 61619	Nuk u zbulua

PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDE

- IEC 60296:2020 Edition 5.0 – Type A (TVAI)
- Testi i korrozionit i kaluar sipas: ASTM D1275 Method B, IEC 62535, DIN 51353
- I aprovuar.

Tipi: Vaj transmisioni 80W-90

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API GL-4 / GL-5
- MT-1
- Scania STO 1:0
- MB 235.0
- MAN 341 Type E2

- MAN 342 Type Z2
- MAN 342 Type M2
- ZF TE-ML 02B, 05A, 07, 08, 12L, 12M, 16B, 17B, 19B, 21A
- Volvo 97321
- John Deere JDM J11E
- Case MS 1316
- Ford M2C197-A

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	13.5 – 18.5
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	110
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	205
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-32

SAE Grade: 10W

NIVELI I CILËSISË / SPECIFIKIMET

- API CF
- API MT-1
- Allison C-4
- Caterpillar TO-4
- DANA Powershift Transmissions
- Komatsu KES07.861.1
- Vickers (35VQ25)
- ZF TE-ML 03C

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Metoda	Vlera
Viskoziteti në 100°C (cSt)	ASTM D445	6 – 7
Indeksi i viskozitetit	ASTM D2270	100
Pika e ndezjes (°C)	ASTM D92	200
Pika e ngrirjes (°C)	ASTM D97	-16
Hiri i sulfatuar (%)	ASTM D874	< 2.0
TBN (mg KOH/g)	ASTM D2896	> 8

Produkt: Tretësirë Ure 32.5% (AdBlue)
Standard referimi: ISO 22241

KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE

Parametri	Rezultati	Specifikimi	Njësia
Përmbajtja e uresë	32.1	31.8 – 33.2	%
Dendësia në 20°C	1.0889	1.0870 – 1.0930	g/ml
Indeksi i refraksionit në 20°C	1.38235	1.3814 – 1.3843	—
Alkaliniteti (NH ₃)	0.01	max 0.2	%
Biuret	0.17	max 0.3	%
Aldehyde	0.10	max 5	mg/kg
Materie e patretshme	10.40	max 20	mg/kg
Fosfat (PO ₄)	0.07	max 0.5	mg/kg
Kalcium (Ca)	0.00	max 0.5	mg/kg
Hekur (Fe)	0.00	max 0.5	mg/kg
Bakër (Cu)	0.00	max 0.2	mg/kg
Zink (Zn)	0.00	max 0.2	mg/kg
Krom (Cr)	0.03	max 0.2	mg/kg
Nikel (Ni)	0.02	max 0.2	mg/kg
Alumin (Al)	0.00	max 0.5	mg/kg
Magnez (Mg)	0.03	max 0.5	mg/kg
Natrium (Na)	0.20	max 0.5	mg/kg
Kalium (K)	0.06	max 0.5	mg/kg

Artikujt objekt prokurimi duhet të jenë me tapë dyfishe dhe amballazh 20 litra.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor për artikujt objekt prokurimi referuar nevojës reale, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u referuar për disa artikuj. Specifikimet teknike të përcaktuara në këto dokumente tenderi i përgjigjen nevojës së autoritetit kontraktor, çka nënkupton plotësimin e nevojave me cilësinë e kërkuar.

Specifikimet teknike për vajrat lubrifikantë janë përcaktuar në përputhje me kërkesat teknike të prodhuesve të automjeteve dhe pajisjeve që përdoren nga autoriteti kontraktor, si dhe me standardet ndërkombëtare të cilësisë për lubrifikantët. Qëllimi i vendosjes së këtyre specifikimeve

është garantimi i funksionimit të sigurt, performancës optimale dhe jetëgjatësisë së motorëve dhe sistemeve hidraulike të mjeteve dhe pajisjeve.

Vajrat lubrifikantë janë element thelbësor për funksionimin korrekt të motorëve dhe mekanizmave të ndryshëm, pasi ato sigurojnë lubrifikimin e pjesëve mekanike, reduktojnë fërkimin dhe konsumimin, ndihmojnë në disipimin e nxehtësisë dhe mbrojnë komponentët nga korrozioni dhe depozitimet e dëmshme.

Në këtë kuadër janë përcaktuar karakteristika fiziko-kimike dhe standarde cilësie të cilat duhet të plotësohen nga produktet e ofruara, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për përdorim në automjetet dhe pajisjet në përdorim.

Përcaktimi i klasës së viskozitetit (SAE)

Specifikimet për vajrat e motorit janë përcaktuar sipas klasifikimit ndërkombëtar SAE (Society of Automotive Engineers), konkretisht për klasat SAE 15W-40 dhe SAE 20W-50, të cilat janë ndër klasat më të përdorura për motorët e automjeteve të rënda, mjeteve të shërbimeve dhe pajisjeve mekanike.

Këto klasa viskoziteti sigurojnë performancë të mirë të vajit në temperatura të ndryshme pune, lubrifikim të qëndrueshëm të motorit gjatë nisjes në temperatura të ulëta, ruajtjen e një filmi mbrojtës të qëndrueshëm në temperatura të larta pune.

Parametrat fiziko-kimikë të vajrave

Parametrat fiziko-kimikë të kërkuar, të testuar sipas metodave standarde ASTM, janë përcaktuar për të garantuar cilësinë dhe performancën e vajit gjatë përdorimit.

Ndër parametrat kryesorë janë Viskoziteti kinematik në 100°C dhe 40°C (ASTM D445) I cili tregon aftësinë e vajit për të ruajtur viskozitetin optimal gjatë funksionimit të motorit dhe për të siguruar lubrifikimin e duhur të komponentëve.

Viskoziteti në temperatura të ulëta (ASTM D5293) siguron që vaji të ruajë rrjedhshmërinë e nevojshme gjatë nisjes së motorit në temperatura të ulëta.

HTHS në 150°C (ASTM D5481) tregon qëndrueshmërinë e filmit lubrifikues në kushte të temperaturave dhe ngarkesave të larta.

Indeksi i viskozitetit (ASTM D2270) vlerëson stabilitetin e viskozitetit të vajit në varësi të ndryshimeve të temperaturës.

Pika e ndezjes (ASTM D92) tregon rezistencën e vajit ndaj avullimit dhe sigurinë gjatë përdorimit në temperatura të larta.

Pika e ngrirjes (ASTM D97) përcakton temperaturën minimale në të cilën vaji ruan karakteristikat e tij funksionale.

TBN – Total Base Number (ASTM D2896) tregon aftësinë e vajit për të neutralizuar acidet që krijohen gjatë djegies në motor.

Këta parametra janë të rëndësishëm për të siguruar që vajrat e përdorur të përmbushin kërkesat e performancës dhe të mbrojnë motorët nga konsumimi dhe degradimi.

Standardet ndërkombëtare të cilësisë

Specifikimet kërkojnë që vajrat të plotësojnë standarde ndërkombëtare të njohura, si:

API (American Petroleum Institute)

ACEA (European Automobile Manufacturers Association)

Standardet e prodhuesve të automjeteve si MAN, Mercedes-Benz, Volvo, Renault, Scania, Iveco, DAF, Deutz etj.

Përfshirja e këtyre standardeve siguron që produktet e ofruara të jenë të certifikuara dhe të përshtatshme për përdorim në motorët e automjeteve të prodhuesve të ndryshëm që përdoren nga autoriteti kontraktor.

Specifikimet për vajin hidraulik

Për sistemet hidraulike është kërkuar vaj hidraulik HLP 68, i cili është një vaj mineral industrial i përdorur gjerësisht në sistemet hidraulike të makinerive dhe pajisjeve.

Ky vaj duhet të përmbushë standarde ndërkombëtare si:

DIN 51524 Part 2 HLP

ISO 6743-4 HM

AFNOR NF-E 48-603

standarde të prodhuesve të pajisjeve hidraulike si Parker Denison, Eaton Vickers, Bosch Rexroth etj.

Këto standarde garantojnë që vaji hidraulik siguron mbrojtje kundër konsumimit të komponentëve, ka stabilitet të mirë termik dhe oksidativ, mbron sistemin nga korrozioni dhe formimi i depozitave, garanton performancë të qëndrueshme të sistemit hidraulik.

Specifikimet teknike të përcaktuara për vajrat lubrifikantë janë hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të industrisë dhe kërkesat teknike të pajisjeve dhe automjeteve në përdorim nga autoriteti kontraktor. Këto kërkesa synojnë të garantojnë furnizimin me produkte cilësore, të certifikuara dhe të përshtatshme për përdorim në kushtet operative të mjeteve dhe pajisjeve, duke siguruar funksionimin e tyre të sigurt dhe efikas.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, është hartuar nga komisioni perkates ne perberje te se cilit është specialisiti i fushes, anetar I Njesise se Prokurimit, bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor, me qëllim finalizimin me sukses te procedures në kushtet kur kjo procedurë është e rishpallur pasi procedura e pare deshtoi sepse asnje prej operatoreve pjesemarrës nuk plotesonte specifikimet teknike mbi cilësinë e lubrifikantëve të parashikuara nga AK.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: